VENDIM
Nr.107, datë 17.10.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË "RREGULLAT E PRAKTIKËS DHE PROCEDURAVE TË ERE-S", TË MIRATUARA ME VENDIMIN NR.21, DATË 18.3.2009 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenit 39 të "Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s", Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.10.2011, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga grupi i punës për disa shtesa dhe ndryshime në "Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s",

VENDOSI:

Të miratojë shtesat dhe ndryshimet në "Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s", të miratuara me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s (ndryshimet bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

SHTESAT DHE NDRYSHIMET NË
"RREGULLAT E PRAKTIKËS DHE PROCEDURAVE TË ERE-S" TË MIRATUARA ME VENDIMIN NR.21, DATË 18.3.2009 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S

A) Në nenin 3 "Zbatimi", pas germës "g" të pikës 1, shtohet germa "h" me përmbajtjen si më poshtë:

"h. trajtimin e ankesave të konsumatorëve.".

B) Në nenin 5 "Sekretar/e", pika 6 ndryshon dhe bëhet:

""Sekretar/e" do të thotë Sekretari/ja e titullarit të ERE-s.".

C) Në nenin 5 "Tarifat dhe çmimet", pika 20 ndryshon dhe bëhet:

""Tarifat dhe çmimet" janë pagesat që duhet të kryhen nga konsumatorët për shërbimet e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, që sigurohen nga shoqëritë e licencuara nga ERE, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Tarifat dhe çmimet e energjisë elektrike apo gazit natyror mund të rishikohen nga ERE me propozim të të licencuarve ose me iniciativën e vetë ERE-s, sipas parimeve të parashikuara në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar dhe në ligjin nr.9646, datë 30.6.2008 "Për gazin natyror.".

D) Në nenin 5, pas pikës 24, shtohen pikat 25 dhe 26:

"25. "Akt individual" do të thotë çdo vendim që krijon pasoja juridike individualisht.

26. "Akt normativ" do të thotë çdo vendim që krijon pasoja juridike për më shumë se një individ.".

DH) Në nenin 8 "Mbledhjet e Bordit të Komisionerëve" pikat 4, 5 dhe 6 ndryshojnë dhe bëhen:

"4. Përpara çdo mbledhjeje të bordit, kryetari përgatit një agjendë të çështjeve për t'u shqyrtuar në bord. Sekretari/ja ua shpërndan këtë agjendë, anëtarëve të Bordit të Komisionerëve, si dhe drejtorive që kanë ndjekur një procedurë. Kjo agjendë është e disponueshme për inspektim publik në zyrat e ERE-s.

5. Njoftimi i mbledhjes, komunikohet të paktën 5 ditë kalendarike përpara datës së caktuar për mbledhjen.

6. Afati i përcaktuar në pikën 5 të këtij neni nuk zbatohet nëse në aktet e tjera ligjore që kanë

fuqi detyruese për ERE-n përcaktohen afate të ndryshme. Në këtë rast agjenda dhe materialet shoqëruese të nevojshme për vendimmarrje do t'i dërgohen bordit të paktën 24 orë para mbledhjes së Bordit.".

DH.1) Në nenin 8 "Mbledhjet e Bordit të Komisionerëve" pas pikës 6 shtohet pika 7 me përmbajtjen:

"7. Me kërkesën e një prej anëtarëve të tij, bordi mund të vendosë të heqë ose shtojë çështje të veçanta nga agjenda e përgatitur.".

E) Në nenin 9 "Mbledhjet jashtë radhe" pas fjalëve "jo më vonë se dy ditë" shtohen fjala "pune".

Ë) Në nenin 12 "Organizimi i mbledhjes së hapur", pikat 3 dhe 4 ndryshojnë si më poshtë:

"3. Në një mbledhje të hapur të bordit të ERE-s, kanë të drejtë të diskutojnë dhe të japin mendime, vetëm anëtarët e bordit dhe përfaqësuesit e ERE-s, si dhe me leje të kryetarit të ERE-s, edhe persona të tjerë që kanë lidhje me çështjet në agjendë.

4. Me kërkesë të palëve të interesuara, sekretarja e bordit u lejon atyre qe të njihen me procesverbalin e mbledhjes, si dhe me vendimin e bordit pas zbardhjes së tyre.".

F) Në nenin 13 "Të drejta e detyrime të publikut", në pikën 1 në fund të fjalisë shtohet paragrafi me përmbajtjen si më poshtë:

"- Mbledhjet e hapura të Bordit të Komisionerëve mund të regjistrohen nga përfaqësues të autorizuar të shtypit të shkruar dhe audioviziv pas miratimit të kryetarit.".

F.1) Pika 3 e këtij neni ndryshon si më poshtë:

"Pika 3 e nenit 13

Kur cenohen rregullat mbi zhvillimin e mbledhjes, kryetari pas konsultimit me bordin vendos për ndërprerjen e mbledhjes për një periudhë të caktuar kohe, ose shtyrjen e saj pas marrjes së miratimit nga bordi.".

G) Në nenin 15 "Vendimmarrja", pas fjalëve "brenda tre ditëve" shtohen fjala "pune nga zbardhja e vendimit".

H) Në nenin 16 "Kërkesë për rishikimin e një vendimi të bordit", ndryshohen dhe bëhen:

"1. Për një vendim të bordit, për një çështje me karakter individual, çdo person i përfshirë në çështje, që ka siguruar apo disponon prova të reja, që mund ta çojnë bordin të marrë një vendim të ndryshëm, personi i prekur nga akti mund t'i kërkojë ERE-s rishikimin e vendimit brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes e njoftimit te vendimit. Bordi do të shqyrtojë provën e re dhe do të nxjerrë vendimin e tij brenda 12 (dymbëdhjetë) ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës për rishikim. Kërkesa për rishikim nuk do të lejojë personin që paraqet kërkesën të ndërpresë ekzekutimin e vendimit të parë të bordit brenda afateve të përcaktuara, përveç kur është pezulluar nga bordi nën autoritetin e tij.

2. Bordi në përputhje me rrethanat specifike të një vendimmarrjeje, me iniciativën e tij mund të rishikojë vendimet me karakter individual. Bordi nuk mund të vendosë me iniciativën e tij për të rishikuar një vendim, kur nga rishikimi kufizohen të drejta të dhëna më parë me vendimin që kërkohet të rishikohet.

3. Për aktet me karakter normativ, çdo palë e përfshirë në proces mund të paraqesë në ERE një kërkesë për rishikim vendimi të Bordit të Komisionerëve brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit të vendimi të bordit. Kërkesa për rishikim vendimi do të shoqërohet detyrimisht me provat e reja që mendohet se mund të çojnë bordin në një vendimmarrje të re. ERE do të trajtojë kërkesën për rishikim vendimi brenda 30 ditëve kalendarike duke ndjekur të njëjtin proces që shërbeu për miratimin e vendimin. Kërkesa për rishikim vendimi nuk pezullon zbatimin e vendimit me përjashtim kur Bordi i Komisionerëve vendos ndryshe.

4. Pezullimi i aktit të miratuar nga ERE, bëhet vetëm nga Bordi i Komisionerëve të saj, sipas një kërkese të paraqitur nga një subjekt i interesuar, në përputhje me rrethanat specifike.

Bordi i Komisionerëve të ERE-s nuk mund të vendosë për pezullimin e zbatimit të një akti të tij, në rastet kur:

- Pezullimi i aktit ndalohet me ligj;
- Zbatimi i menjëhershëm i tij është në interes publik.".

H.1 Pas nenit 16 shtohet neni 16/1:

“Neni 16/1

Çdo person në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe ligjin nr.9646, datë 30.6.2008 “Për gazin natyror” mund të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare.”.

I) Në nenin 17 “Regjistrimi i aplikimit apo kërkesës”, pika 4 ndryshon dhe bëhet:

“4. Të gjithë regjistrat, shënimet dhe materialet e tjera të përshkruara në këtë nen, janë të hapura për publikun me përjashtim të atyre që trajtohen si konfidenciale, sikurse vendosur sipas rastit nga organet drejtuese të ERE-s.”.

J) Në nenin 18 “Fillimi i procedurës”, në pikën 1 pas germës “d” shtohet germa “e” me përmbajtjen si më poshtë:

“e) për kërkesat për përjashtim nga aksesi i palëve të treta të infrastrukturave të reja apo ekzistuese të gazit natyror.”.

J.1) Kudo në këtë nen afatet përcaktohen në ditë pune.

J.2) Pika 4 dhe 5 e nenit 18 hiqet.

K) Në nenin 20 “Procedura e aplikimeve për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve”, pika 1 ndryshon dhe bëhet:

“1. I licencuari që kërkon përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, sipas metodologjisë përkatëse dhe rregullave të tjera të ERE-s.”.

L) Në nenin 21 “Rregulla të veçanta për paraqitjen e aplikimeve për përcaktimin/rishikimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe/apo të gazit natyror nga shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e energjisë”, pika 7 ndryshon dhe bëhet:

“7. Pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit aplikuesi duhet të njoftojë:

- Brenda 10 ditëve kalendarike publikun, nëpërmjet botimit jo më pak se në dy/tre gazeta me qarkullim në nivel vendi, apo në zonën ku aplikuesi siguron shërbimin, në lidhje me masën e propozuar për ndryshimin e tarifave dhe çmimeve, si dhe përqindjen e ndryshimit të tyre për çdo klasë/grup konsumatorësh duke shprehur qartë emërtimin e tyre.

- Në rastet kur aplikuesi nuk bën publikimin sipas paragrafit të mësipërm, ERE-ja mund të vendosë për penalizimin e aplikuesit dhe bën publikimin e aplikimit sipas kërkesave të paragrafit të mësipërm. Kostot e botimit të këtij njoftimi i transferohen subjektit që ka detyrimin për zbatimin e paragrafit të parë të pikës 7.”.

LL) Në nenin 22 “Zgjidhja e ankesave” bëhen këto ndryshime:

Pika 1 ndryshon si më poshtë:

“Për mosmarrëveshjet midis të licencuarit dhe klientëve të tij, si dhe midis vetë të licencuarve, çdo ankues duhet të paraqesë në ERE kërkesën duke përdorur formën standarde që i bashkëlidhet këtyre rregullave.”.

Pika 7 ndryshon si më poshtë:

“Ankesat që përmbajnë materiale fyese ose denigruese nuk trajtohen nga ERE, pa paragjykuar nëse ai ankues mund të ketë paraqitur një ankesë të ligjshme. ERE i bën me dije ankuesit arsyet e mostrajtimit të ankesës së tij.”.

Pika 10 ndryshon dhe bëhet:

“Në çdo rast ERE rezervon të drejtën për të zhvilluar seanca dëgjimore publike, si dhe/apo të kryejë kryesisht verifikime apo inspektime.”.

LL.1) Pas pikës 11 shtohen pikat 12, 13 dhe 14 me përmbajtjen si më poshtë:

“12. Për mosmarrëveshjet midis të licencuarve apo midis të licencuarit dhe konsumatorit, objekti i të cilëve paralelisht lidhet me një vendimmarrje tjetër në proces nga Bordi i Komisionerëve, atëherë afatet e përcaktuara me sipër apo zhvillimi i mundshëm i seancave dëgjimore do të bëhet në afate të ndryshme nga sa përcaktuar në këtë nen, për të mundësuar trajtimin e ankesës brenda afatit të shqyrtimit të çështjes në procedim nga bordi që ka lidhje edhe me objektin e ankesës.

13. Për ankesat e përsëritura të paraqitura nga të licencuarit, me të njëjtat palë dhe me të

njëjtin objekt, njoftohen anëtarët e bordit brenda 2 ditësh pune për ankesën apo mosmarrëveshjen e riparaqitur në ERE dhe brenda 5 ditësh pune nga njohja me të, kryetari zhvillon një mbledhje të bordit, i cili përcakton më pas natyrën sesi do të procedohet me ankimin apo mosmarrëveshjen. Mbledhjet e bordit të parashikuara sipas kësaj pike do të jenë të karakterit informativ dhe udhëzues për zgjidhjen e çështjes objekt i mosmarrëveshjes, apo ankesës nga personeli teknik i ERE-s. Për ankesat e përsëritura të paraqitura nga konsumatorët ndaj një të licencuari, bordi mund të vendosë rast pas rasti me kërkesë të kryetarit për zgjidhjen e mëtejshme të ankesës.

14. Në çdo kohë kur e konsideron të nevojshme kryetari i ERE-s mund të kërkojë trajtimin nga Bordi i Komisionerëve të një ankese të paraqitur në ERE, brenda autoritetit dhe kompetencës së dhënë nga legjislacioni në fuqi.".

M) Pika 2 e nenit 23 ndryshon dhe bëhet:

"Çdo person që paraqet një kërkesë në ERE mund ta dërgojë atë nëpërmjet postës zyrtare apo në rrugë elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.".

N) Në nenin 25 ndryshon titulli dhe bëhet: "Rregullat për hartimin e miratimin e akteve nënligjore me statusin: rregullore, udhëzim, metodologji etj.".

N.1) Pikat 1, 3 dhe 4 të këtij neni ndryshojnë dhe bëhen:

"1. Për hartimin e një akti nënligjor që ka të bëjë me ushtrimin nga ana e ERE-s të autoritetit në drejtim të miratimit të legjislacionit sekondar, me iniciativën e vet apo me propozim të subjekteve që kanë të drejtën e hartimit të një akti, objekt i miratimit nga ERE, kryetari, në konsultim me anëtarët e bordit, urdhëron ngritjen e një grupi pune. Pas hartimit të draftit, apo pas analizës së draftit, në rastet e propozimeve nga subjektet që kanë të drejtën e një propozimi në ERE, ky grup pune publikon për 3 ditë pune një njoftim në 2 gazeta me qarkullim kombëtar duke ftuar palët e interesuara ose persona të tjerë të njihen me projektaktin dhe të dërgojnë komente me shkrim.

3. Të gjitha palët e interesuara do të dërgojnë komentet e tyre me shkrim për projektaktin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga dita e publikimit të njoftimit.

4. ERE do t'i dërgojë kopje të aktit të miratuar të gjitha palëve që kanë shprehur komente apo interes në proces.".

N.1) Në pikën 5 pas fjalëve "jo më pak se tre ditë" shtohen fjala "pune".

NJ) Në nenin 26 ndryshon titulli dhe bëhet: "Rishikimi i akteve nënligjore me statusin: rregullore, udhëzim, metodologji etj.".

NJ.1) Pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni ndryshojnë dhe bëhen:

"2. Procesi i rishikimit të akteve nënligjore me iniciativën e ERE-s, nis vetëm pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurave nga bordi.

3. Për rishikimin e akteve nënligjore me statusin: rregullore, udhëzim, metodologji etj.", me kërkesë të palëve të interesuara, para marrjes së vendimit nga bordi për miratimin ose jo të ndryshimeve të propozuara, ERE do të zhvillojë një seancë dëgjimi me subjektin që ka kërkuar ndryshimin apo palët e interesuara, duke ftuar dhe sipas rastit, palët e tjera, që mund të preken nga ndryshimet e propozuara.

4. Për rishikimin e akteve nënligjore me iniciativën e ERE-s apo me kërkesë të palëve të interesuara ndiqet e njëjta procedurë e përcaktuar në nenin 25, pikat 1, 2, dhe 3 të këtyre rregullave.".

O) Në nenin 31, pika 1 ndryshon dhe bëhet:

"- Për seancat dëgjimore të përgjithshme dhe teknike ERE njofton secilën nga palët që ka shprehur interes, si dhe palët e identifikuara të nevojshme për procesin, jo më vonë se 5 ditë kalendarike nga data e planifikuar për zhvillimin e seancës. Njoftimi përmban informacion mbi datën, orën, vendin, qëllimin e zhvillimit të seancës dëgjimore, si dhe dokumentacionin e administruar nga ERE për çështjen objekt të seancës dëgjimore.".

P) Në nenin 33 "Rregulla të zhvillimit të seancës dëgjimore", pika 9 ndryshohet dhe bëhet:

"9. Nëse një seancë dëgjimore nuk arrin të ezaurojë të gjitha çështjet e planifikuara, ajo mundet të vazhdojë në një datë tjetër, e cila do të komunikohet nga ERE në përfundimin e seancës në fjalë ose nëpërmjet një komunikimi tjetër, i cili duhet t'u bëhet palëve të interesuara jo më vonë se një ditë kalendarike përpara organizimit të vijimit të seancës.".

Q) Në nenin 38 "Konflikti me funksionet ligjore ose institucionale", riformulohet dhe bëhet:

“Këto rregulla janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, autoritetin dhe funksionet ligjore të ERE-s. Në rast konflikti mes legjislacionit në fuqi që ka të bëjë me autoritetin dhe kompetencat e ERE-s dhe këtyre rregullave, do të prevalojë legjislacioni në fuqi.”.